



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.788/2014

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur në objektin e degës së kësaj gjykate në Vushtrri) departamenti i përgjithshëm, si kontestimore e përberë nga gjyqtari individual Faton Ademi, ne çështjen juridike të paditësit: _____ nga _____ të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. _____ kundër të paditurit: _____ e _____ me seli në _____ për shkak të kompensimit të demit, vlera e kontestit 7100 euro pas mbajtjes së seancës kryesore, me datë:16.06.2016

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESRISHT kërkesëpadia e paditësit _____ nga _____

II. OBLIGOHET e paditura _____ e _____ me seli në _____ që në emër të kompensimit të demit material dhe jo material, për të gjitha llojet e demit, paditësit _____ t'ia kompensoi shumën totale prej **2600 (dy mijë e gashtëqind) euro**, me kamat prej 8% që nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, e gjer në pagesën definitive të borxhit dhe atë:

_____ në emër të të gjitha dhimbjeve fizike të pësuar shumën prej **900 euro**

_____ në emër të të gjitha formave të frikës së pësuar shumën prej **1100 euro**

_____ në emër të shpenzimeve për ushqim të përforcuar shumën prej **200 euro**

_____ në emër të kujdesit të huaj shumën prej **200 euro**

_____ në emër të shpenzimeve për rehabilitim klimatik shumën prej **200 euro**

III. OBLIGOHET e paditura Kompania e Sigurimeve _____ me seli në Prishtinë, që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore paditëses t'ia paguaj shumën totale **1, 073.80 (një mijë e shtatëdhjetë e tri euro e tetëdhjetë cent) euro**, dhe atë: për përpilimin e padisë shumën prej **104 euro**, për precizim të padisë shumën prej 104 euro, në emër të 4 seancave gjyqësore shumën prej 540.80 euro, në emër të dy ekspertiza mjekësore

shumën prej 200 euro, në emër të ekspertizës së komunikacionit shumën prej 100 euro, 25 euro në emër të taksës për padi shumën prej 25 euro si dhe gjykatës në emër të taksës për aktgjykim shumën prej 25 euro, e paditura ka obligim që t'i përmbush të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

IV. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses përtej shumës së gjykuar në lartësi prej 4500 euro REFUZOHET SI E PABAZUAR

A r s y e t i m

Paditësja me date 24.11.2014 ka ushtruar padi kundër te paditurës, për kompensimin e demit material dhe jo material, të shkaktuar në aksidentin e datës 05.03.2013.

E paditura nuk ka prezantuar në pjesën dërmuese të seancave, ndërsa në këtë qështje u caktua ekspertiza e komunikacionit për të vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadisë.

Ndërsa për të vërtetuar dëmin dhe frikën e pësuar të paditësit në aksidentin e komunikacionit gjykata në bazë të propozimit të palës paditëse caktoi ekpeertët mjekësorë nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë.

Përfaqësuesi i të paditurës në seancë kryesore të datës: 28.04.2016 deklaroi se nuk është kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, meqenëse paditësit edhe në procedurë administrative i është ofruar shuma prej 530 euro, ndërsa me qëllim të ekonomizimit të procedurës paditësit i ofroi shumën prej 1 000 euro në emër të të gjitha dëmëve material dhe jo material si dhe shpenzimet e procedurës.

I autorizuari i paditësit deklaroi se mbetet pranë precizimit të dorëzuar të dt.23.02.2015; po ashtu edhe në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit mbeti pranë këtij propozimi, duke konsideruar se kërkesëpadija është e bazuar si për nga baza po ashtu edhe për nga lartësia si dhe kërkoi që e njëjta të aprovohet në tërësi si e bazuar, si dhe shpenzimet e procedurës përveq atyre të kërkuar edhe për një seancë shtesë shumën prej 135 euro.

Përfaqësuesi i të paditurës në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetet si në deklaratimet e lartcekura, gjykatës i propozoj se me rastin e vendosjes përtej shumës së ofruar në këtë seancë e njëjta të refuzohet si e pa bazuar.

Me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike gjykata nxorri dhe administroi këto prova: mendimet e specialistëve mjekësorë nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë, ekspertizën e komunikacionit, raportin e aksidentit nr. dt.05.03.2013 bashkë me skicën e terrenit, raporti i emergjencës pranë _____ në _____, raporti i emergjencës _____, raporti i Klinikës së _____, raporti i _____, raporti i _____, raporti i psikiatrit, raporti i ortopedit, dëftesa mbi pagesën e dt.3.03.2013, kopja e Lnj. Të paditësit, precizimi i kërkesës, procesverbali i dt.12.01.2015.

Gjykata provat e administruara i vlerësoi një nga një dhe në raport me njëra tjetër dhe në bazë të qmuarjes së lirë të provave dhe rezultatit të tërë procedurës vendosi që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovoi pjesërisht të BAZUAR për këto arsye:

Nuk është kontestues fakti që automjeti " " i tipit " " i vitit të prodhimit 2012 me tabela " " në momentin e aksidentit ka qene e regjistruar te e paditura dhe ka poseduar polisë valide të sigurimit të vlefshme sigurimi deri më datën 07.03.2013.

Gjykata lidhur me bazën e kërkesëpadisë u bazua në raportin e policor nr. " " i datës 05.03.2013, ekspertiza e komunikacionit e dt.01.12.2015, ashtu që kjo konstatoi se i siguruari i të paditurës ka qenë shkaktar i vetëm i aksidentit të komunikacionit si rezultat i të cili paditësi ka pësuar dëmë, dhe meqenëse automjeti ka pasur sigurim kufitar pranë të paditurës, përgjegjësia për kompensimin e dëmit bie mbi të paditurën sipas nenit 19 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

Gjykata lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë , sipas pikës II të dispozitivit u bazua jo në tersi por vetëm si pike reference në kriteret e kompanive për lartësinë e kompensimit të shkaktuar ne aksidentin e komunikacionit, ne mendimet dhe konstatimet e ekspertëve mjekësor nga lemia e psikiatrisë dhe ortopedisë-traumatologjisë, të cilët ne ekspertizat e tyre , konstatuan se paditësi me rastin e aksidentit ka pësuar lëndime trupore, i cili ka shkaktuar te paditësi dhimbje fizike te intensitetit te rende për 72 ore, dhimbje fizike te intensitetit te mesëm prej 4 javësh, dhimbje të intensitetit te ulte janë prezentë edhe sot e kësaj dite, ndihma dhe përkujdesja nga personi tjetër paditëses i është dashur në kohëzgjatje prej 3 javësh, ushqimi i përforcuar ka qene i nevojshëm në kohëzgjatje prej 2 javësh, rehabilitimi fizioterapeutik-klimatik paditëses ka qene i nevojshëm ne kohëzgjatje prej 2 jave,

Eksperti i Psikiatrisë konstatoi se paditësi me rastin e aksidentit ka pësuar: frik primare ka zgjatur disa sekonda, frik sekondare e intensiteti te larte qe ka zgjatur 7 ore, frik sekondare e intensitetit mesatar qe ka zgjatur 1 muaj dhe frik sekondare e intensitetit te ulte qe ka zgjatur 2 muaj dhe frikë sekondare e intensitetit të ultë 3 muaj.

Prandaj, Gjykata bazuar në nenin 136, 137, 159, 169, 170, 183, të Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe nenit 19 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

Gjykata, lidhur me shpenzimet e procedurës, u bazua në nenin 449, 453 dhe 452 par.2 të LPK-së, dhe vlerësoi se e paditura duhet t'ia kompensoi paditëses në tersi shpenzimet e procedurës, të cilat edhe ashtu me aprovimin e pjesërisht të kërkesëpadisë kanë qene të domosdoshme në shkaktimin e tyre me qellim të vërtetimit të bazës dhe lartësisë së kërkesëpadisë, prandaj edhe vendosi si në diapozitiv të pikës III të këtij aktgjykimi.

Gjykata, lidhur me përlogaritjen e kamatës, u bazua në nenin 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton: “ Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla, përpos borgjit kryesor edhe kamatën, ndërsa paragrafi 2 : Lartësia e Kamatvonesës është tetë (8) % në vit, nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”.

Lartësia e kompensimit të dëmit për të gjitha llojet e tij sipas vlerësimit të gjykatës është në përputhje me dëmin e pësuar pra të mirën e goditur, pastaj është në përputhje edhe me praktikën gjyqësore për kompensimin e dëmit të lëndimi i lehtë trupor, pavarësisht faktit se secili rast mund të jetë me disa karakteristika specifike mirëpo në instancë të fundit dihet mirëfilli një praktikë e përgjithshme e kompensimit të këtyre rasteve.

Gjykata në emër të frikës paditësit ia caktoi shumën më të madhe se sa në emër të dhimbjeve mbi bazën e asaj se paditësi në momentin e aksidentit sipas vlerësimit të ekspertit të psikiatrisë e ka përjetuar dhe parë aksidentin drejtëpërdrejt me sytë e tij e cila është manifestuar me frikë primare që ka zgjatur disa sekonda e që ka qenë frikë nga vdekja, ndërsa për shkak të llojit të lëndimit që ka qenë lëndim i lehtë trupor i njëjti nuk ka pasur dhimbje të intensitetit posaçërisht të randë, por të një intensiteti më të ultë.

Gjykata, lidhur me pjesën **IV** të kërkesëpadisë, respektivisht pjesën refuzuese të kërkesëpadisë së paditësit, u bazua në shkresat e lendes, dhe konstatoi se shumata e kërkuar nga i autorizuari i paditëses në precizimin të kërkesëpadisë është shume e lartë në krahasim me natyrën, kohëzgjatjen, intensitetin e lëndimeve, frikës dhe pasojave tjera që paditësi i ka pësuar në aksidentin në fjale, ashtu që edhe në mungesë të argumentimit të kësaj lartësie nga paditësi, gjykata vendosi si në këtë pikë të dispozitivit.

Gjykata, aktgjykimin e saj e mbështeti në nenin 143 par.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.788/2014, me dt 16.06.2016

G J Y Q T A R I
Faton Ademi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat 15 ditor nga data e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.